

Të (pa) barabartë: Një tregim mbi Konkurrencën në Kosovë

—
Shtator 2018





GRUPI PËR STUDIME
JURIDIKE DHE
POLITIKE

Grupi për Studime Juridike dhe Politike

Është një organizatë e pavarur, jopartiake dhe jo-fitimprurëse e politikave, me qendër në Prishtinë, Kosovë.

Misioni ynë është që të zhvillojmë hulumtime të besueshme në fushën e politikës, ligjit dhe ekonomisë dhe të shtyejmë përpara zgjidhjet e politikave që adresojnë dështimet dhe/ose trajtojnë problemet në fushat e lartpërmendura

Raport Politikash 04/2018

Të (pa) barabartë: Një tregim mbi Konkurrencën në Kosovë

Autorë: *Erëza Pula dhe Delfinë Elshani

Shtator 2018

© Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Shtator, 2018.

Opinionet e shprehura në këtë dokument jo domosdoshmërisht pasqyrojnë qëndrimet e Grupit për Studime Juridike dhe Politike dhe Institutit të Prishtinës për Studime Politke, donatorëve e këshillit, stafit të tyre, apo anëtarëve të bordit. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet apo përdoret në çfarëdo forme pa leje paraprake. Për kërkesa të kësaj natyre kontaktoni zyrën administrative të Grupit për Studime Juridike dhe Politike.

Grupi për Studime Juridike dhe Politike
Rr. "Rexhep Luci" str. 16/1
Prishtinë 10 000, Kosovë
Web-site: www.legalpoliticalstudies.org
E-mail: office@legalpoliticalstudies.org
Tel/fax.: +381 38 234 456

*Hulumtues i Lartë, Grupi për Studime Juridike dhe Politike

"Ky botim është realizuar me përkrahjen e Agjensionit Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida), menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Grupit për Studime Juridike dhe Politike dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i Sida-së, dhe KCSF-së."

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

TË (PA) BARABARTË: NJË TREGIM MBI KONKURENCËN NË KOSOVË

1. Hyrje

Konkurrenca e mirëfilltë është boshti kryesor i ekonomisë mirë-funksionale të tregut. Rregullimi i konkurrencës së tregut është i rëndësishëm thelbësor; ofron bazë për furnizim dhe kërkesë në treg, nxit inovacione kreative, promovon efikasitet, mbron interesat e konsumatorëve, dhe që është më e rëndësishmja, ofron konkurrencë në treg përmes politikave të drejta ekonomike. Qëllimi kryesor i politikave të konkurrencës qëndron në krijimin e rregullave efektive, të cilat shpesh në funksionimin e mirëfilltë të tregut, duke e promovuar cilësinë më të mirë, çmimet më të ulëta, fuqizon inovacionet dhe llojlojshmërinë më të gjerë për konsumatorët.

Tregu i lirë është gurë themel i procesit të ndërtimit të Evropës i cili ishte prezantuar qysh në Traktatin e Romës në vitin 1957, dhe për këtë institucionet aktuale të BE-së japin një theks të veçantë në këtë fushë për shtetet me perspektive për tu anëtarësuar. Pasi që shtetet e Ballkanit Perëndimor (BP) janë përkushtuar në drejtim të shtegut të integritimit Evropian përmes Procesit të Stabilizim Asociimit (PSA), politika e konkurrencës, në mes tjerash, gjithashtu është bërë vendimtare për të arritur liberalizimin e tregtisë në mes të shteteve të BP-së dhe të BE-së. Sidoqoftë, zhvillimi i politikës së vërtetë të konkurrencës në vendet e BP-së ka përparuar në një ritëm të ngadaltë për shkak të mjedisit të komplikuar të tregut në këto vende, mungesës së rregulluesve të pavarur të tregut, si dhe faktorëve të tjerë të tillë si sfidat e procesit të privatizimit, ndikimi i politikës dhe paqëndrueshmëria ekonomike dhe politike.¹

Thënë këtë, konkurrenca e tregut në Kosovë rregullohet me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, i cili shtrin mandatin e rregullimit dhe sigurimit të konkurrencës së drejtë në treg ndaj Autoritetit Kosovar të Konkurrencës (AKK), i themeluar në vitin 2008. Ligji përkufizon rolin dhe përgjegjësitë e rregullatorit të pavarur të tregut. Duke e marrë parasysh peshën e tij dhe pasi që është parim kritik i tregut të vetëm, shumica e reformave dhe politikave të konkurrencës janë ndërmarr në dy (2) korniza kryesore, të hartuara veçanërisht për të përshpejtuar zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), nën emrin Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA), si dhe Agjendën për Reforma Evropiane (ARE).

Politikat e konkurrencës mbeten vendimtare për funksionimin e tregut, veçanërisht duke konsideruar rreziqet të cilat kanosen nga tregjet me përqendrim të lartë, ku janë të zakonshme mono-polet dhe marrëveshjet tjera anti-konkurrencë të cilat çrregullojnë tregun. Për këtë qëllim, ky studim parimisht është i ndarë në dy pjesë kryesore; fillimisht dhe shkurt e analizon performancën e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës gjatë viteve dhe pastaj ofron rezultatet e monitorimit të Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, gjithashtu edhe të ERA-s, me referencë të veçantë ndaj fushës së konkurrencës. Me saktësisht, studimi është strukturuar si në vijim: Seksioni II vlerëson performancën e AKK-së duke u përqendruar në burimet njerëzore dhe kapacitetet buxhetore, Komisionin e Autoritetit, bashkëpunimin në mes të rregullatorëve të tregut, si dhe sfidat e me të cilat janë ballafaquar gjatë viteve. Gjithashtu ky Seksion shkurtimisht shtjellon zhvillimet e fundit lidhur me fushën e Ndihmës Shtetërore. Seksioni III ofron një analizë të rezultateve të procesit të monitorimit të PKZMSA dhe kapitujt e konkurrencës së ARE-së dhe identifikon përparimin e institucioneve dhe gatishmërinë e tyre për ti plotësuar objektivat të cilat

¹ Penev, S., Marusic, A., Mancellari, A., Milovic, N., Causevic, F. dhe Hyseni, D. (2013) Politika e Konkurrencës në Shtetet e Ballkanit Perëndimor. *Raport i Hulumtimit*. Ëestminster Foundation for Democracy (ËFD). Qasja përmes: http://www.npcbalkan.net/admin/doc/Competition_Policy_in_Western_Balkan_Countries.pdf [i futur më: 5 korrik 2018]

dalin nga këto dy dokumente kritike, përderisa Seksioni i fundit ofron vërejtjet përfundimtare për konkurrencën.

2. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës

Sikurse u tha, tregu i Kosovës është i rregulluar me Ligjin Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, i cili është ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-226 në vitin 2014. Në bazë të Ligjit, institucioni i pavarur publik i cili e siguron konkurrencën e drejtë në treg është Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, i cili është themeluar nga Kuvendi në vitin 2008. Kjo kornizë legjislative specifikon rregullat dhe procedurat kryesore në drejtim të garantimit të tregut të konkurrencës së lirë dhe efektive, si dhe aktivitetet dhe përgjegjësitë e AKK-së. Ligji trajton të gjitha veprimet të cilat kufizojnë dhe çrregullojnë konkurrencën brenda dhe jashtë territorit të Kosovës, përfshirë marrëveshjet e ndaluara në formë të karteleve (aleancave), keqpërdorimit të pozitës dominuese dhe shkrirjet/përqendrimet.

Komisioni i Autoritetit

Sikurse është përcaktuar në kornizën ligjore, aktivitetet e Autoritetit udhëhiqen nga Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, i përbërë nga pesë anëtarë. Komisioni ka të drejtë që të propozoj akte nënligjore, lëshoj vendime për fillimin, apo të drejtoj procesin e përcaktimit të praktikave anti-konkurrencë, vë sanksione, propozoj afate dhe ekzekutoj sanksione, si dhe të përkufizoj masat, kushtet dhe afatet për rivendosjen e konkurrencës në treg. Për më tepër, gjithashtu ka të drejtë që të nis hetimet për një entitet të caktuar pa pëlqimin paraprak me një aprovim juridik, si dhe të promovoj dhe rris vetëdijen lidhur me konkurrencën e drejtë në treg. Gjithashtu luan një rol në fushën legjislative, pasi që duhet të ofroj mendime lidhur me përputhshmërinë e draft-ligjeve dhe rregulloreve tjera në kuadër të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, të përkufizoj rregulloret dhe masat për mbrojtjen e konkurrencës dhe bashkëpunoj me organizatat dhe institucionet ndërkombëtare lidhur me çështjet që lidhen me konkurrencën në treg. Komisioni është gjithashtu përgjegjës për hartimin e raportit vjetor të punës së AKK-së dhe dorëzimin e tij në Kuvend.²

Që nga themelimi në vitin 2008, Autoriteti nuk ka pasur mundësi që të angazhohet dhe ti realizoj përgjegjësitë tija për shkak të pasivitetit shumë të gjatë kohor të Komisionit, duke e lënë tregun thellësisht të pa vëzhguar. Kjo situatë ka qenë pasojë e paaftësisë së Qeverisë që të propozoj anëtarë të rinj të Komisionit. Si pasqyrohet në figurën më poshtë, komisioni ka qenë aktiv që nga themelimi deri në nëntor të vitit 2013; sidoqoftë, nga nëntori 2011 ka vepruar vetëm me tre anëtarë. Deri më vitin 2013, dy prej këtyre anëtarëve i kishte skaduar mandati, gjë e cila e ka shtyer Komisionin që mos të jetë më aktiv, me veç një anëtarë deri në vitin 2015, dhe me asnjë anëtarë deri në qershor të vitit 2016. Për këtë arsye, nga nëntori 2013 deri më qershor 2016, Komisioni i Autoritetit nuk ka qenë aktiv, si rezultat i ka paralizuar të gjitha aktivitetet/vendimet e tija dhe hetimin e tregut për gati tri vite.³ Në qershor të vitit 2016, Komisioni i ka rimarrë përgjegjësitë e veta pasi përfundimisht Kuvendi i ka aprovuar anëtarët e propozuar nga Qeveria.⁴

²Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës nr. 03/L-229, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-226

³Hoxha, D. (2013) "Rregullatori i Konkurrencës Nën Menaxhim të Çrregullt". [Online] *Jeta në Kosovë*. 5 gusht 2013. Qasja në: <http://kallxo.com/gjnk/rregullatori-i-konkurrencës-nën-menaxhim-te-çrregullt/> [i futur më: 10 korrik 2018]

⁴TELEGRAFI (2016) "Pas pesë vjetësh kompletohet Autoriteti i Konkurrencës". [Online] qasja në: <http://telegrafi.com/pas-pese-vjetesh-kompletohet-autoriteti-konkurrencës/> [i futur më: 20 korrik 2018]

Fig 1: Përbërja e Komisionit të AKK-së

2008-2011	<ul style="list-style-type: none"> •Aktiv •5 Anëtarë
2011-2013	<ul style="list-style-type: none"> •Aktiv •5 Anëtarë
2013-2015	<ul style="list-style-type: none"> •Aktiv •3 Anëtarë
2015-2016	<ul style="list-style-type: none"> •Joaktiv •1 Anëtar
2016- deri tash	<ul style="list-style-type: none"> •Aktiv •5 Anëtarë

Kishte shumë pretendime të cilat kanë sugjeruar që anëtarët e propozuar për emërimet e fundit ishin ose të lidhur politikisht dhe/ose profesionalisht jo kompetent. Sipas ish-anëtarëve të Këshillit për Zhvillim Ekonomik, infrastrukturë, Tregti dhe Industri, kandidatët vetëm formalisht i kanë plotësuar kriteret, me mungesë të referencave dhe përvojës së nevojshme për të rregulluar konkurrencën e tregut.⁵ Mendimet e ngjashme ishin shprehur gjithashtu nga ekspertët dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile duke pretenduar që kandidatët ishin vetëm politikisht të caktuar.⁶ Sa i përket kësaj, Qeveria i ka neglizhuar kërkesat e vazhdueshme të akterëve relevant për rishikimin e vendimit për emërimet e anëtarëve të Komisionit.⁷

Buxheti dhe struktura organizative

Buxheti për aktivitete ditore të AKK-së është ndarë nga buxheti i Kosovës, i aprovuar nga Kuvendi. Deri më vitin 2018, Autoriteti ka pasur një ndarje të pamjaftueshme të buxhetit, gjë e cila ka pasur ndikim negativ në performancë dhe efikasitet. Pas kërkesave të vazhdueshme nga ky organ rregullator, më në fund është aprovuar rritja e buxheti për shpenzime të aktiviteteve ditore. Rritja e vitit 2018, prej afro 31%, plotësisht i atribuohet kategorisë së pagave dhe mëditjeve. Për këtë, Autoriteti i ka rritur kapacitetet e tyre duke punësuar katër punonjës të rinj, të cilët ishin thelbësor në drejtim të realizimit të mirëfilltë të hetimeve të tregut. Duhet të ceket se Komisioni është në proces të punësimit të tri punëtorëve të tjerë, në përputhje me buxhetin e ndarë.⁸

⁵ Kosova Sot (2016) "Autoriteti i Konkurrencës, në mëshirën e Kuvendit" [Online] qasja në: <http://kosova-sot.info/lajme/104414/autoriteti-i-konkurrences-ne-meshiren-e-kuvendit/> [I futur më: 03 gusht 2018]; Kosova Press (2016) "Emrat për Autoritetin e Konkurrencës pa përvojë të duhur". [Online] Qasja në: <http://www.kosovapress.com/sq/biznes/emrat-per-autoritetin-e-konkurrences-pa-pervoje-nuk-reflektojne-per-mbrojtjen-e-konkurrences-71113/> [I futur më: 25 korrik 2018]

⁶[2] Kosova Sot (2016) Autoriteti i Konkurrencës, në shërbim të mafio-oligarkeve. [Online] qasja në: <http://www.kosova-sot.info/lajme/198846/autoriteti-i-konkurrences-ne-sherbim-te-mafio-oligarkeve/> [I futur më: 15 korrik 2018]

⁷Halimi, S. (2016) Militantë edhe në Bordin e Konkurrencës. [Online] Qasja në: <http://zeri.info/ekonomia/81303/militante-edhe-ne-bordin-e-konkurrences/>[I futur më: 2 korrik 2018]

⁸ Intervista me Z. Valon Prestreshi, Kryetar i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, 24 Korrik 2018

Tabela I: Buxheti dhe Punonjësit e AKK-së

Viti	Buxheti (€)	Nr. i punonjësve të aprovuar	Nr. i punonjësve aktual
2013	255,043	23	15
2014	255,043	23	13
2015	266,350	23	12
2016	224,810	23	17
2017	252,965	23	18
2018	332,409	25	22

Burimi: të dhënat e nxjerra nga buxheti i Kosovës, raporti OECD 2016, dhe Autoriteti Kosovar i Konkurrencës

Deri në vitin 2018, struktura organizative e Autoritetit ka qenë e përbërë nga Komisioni, Sekretariati, Departamenti Administrativ dhe Juridik, si dhe Departamenti për Mbikëqyrjen e Tregut. Sidoqoftë, rritja e buxhetit për 31% e ka krijuar rrugën në drejtim të krijimit të katër divizioneve të reja në kuadër të Departamentit për Mbikëqyrjen e Tregut, përfshirë aty:

- divizionin për analiza, metodologji dhe marrëveshje të veçanta;
- divizionin e përqendrimeve;
- divizionin e pozitës dominuese; dhe,
- divizionin për marrëveshjet e ndaluara (kartelet).

Paralelisht, punonjësit me përvojë pune prej më shumë se gjashtë vite janë promovuar në pozitë e drejtorëve të çdo divizioni.

Ndryshimet e fundit pozitive, përfshirë rritjen e buxhetit dhe numrit të punonjësve si dhe me krijimin e divizioneve të reja, munden që të ndikojnë pozitivisht në performancën dhe efikasitetin e përgjithshëm të Autoritetit, duke çuar në rregullim më të mirë të tregut në Kosovë. Sipas Kryetarit të Komisionit, rastet e hetimeve të tregut do të klasifikohen në bazë të divizioneve të caktuara, duke e lehtësuar kështu menaxhimin e përgjithshëm të rasteve. Për më shumë, sa i përket afatit më të gjatë, çdo divizion do të fuqizoj ekspertizën e tyre dhe do të jetë i specializuar në fushën e caktuar të konkurrencës.⁹

Për më shumë, duhet të ceket se zyra administrative për kontrollimin e ndihmës shtetërore, e njohur me emrin Zyra për Ndihmë Shtetërore, fillimisht ka qenë e themeluar në kuadër të AKK-së. Megjithatë, në bazë të Ligjit të ri për Ndihmë Shtetërore, Departamenti për Ndihmë Shtetërore është bartur në kuadër të Ministrisë së Financave që nga viti 2017.¹⁰ Për momentin i ka shtatë punonjës; shumica prej të cilëve të punësuar në maj të vitit 2018. Për më shumë, për ti fuqizuar më tutje kapacitetet e tyre, Departamenti ka pranuar asistencë teknike nga Bashkimi Evropian dhe pritet të pranojë një ekspert nga Ambasada Britanike.¹¹ Ligji për Ndihmë Shtetërore gjithashtu përcakton që organi vendim-marrës për Departamentin e Ndihmës Shtetërore, gjegjësisht Komisioni për Ndihmë Shtetërore, duhet të përbëhet nga pesë anëtarë me ekspertizat e fushës përkatëse. Anëtarët e komisionit janë të emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për një mandat tri-vjeçar, me mundësi të zgjedhjes për edhe një mandat shtesë.¹² Sa i përket kësaj, Kuvendi e ka nisur procedurën e zgjedhjes për anëtarë të Komisionit për Ndihmë Shtetërore, aplikimi për të cilin ka qenë i hapur prej 17 deri më 31 korrik 2018. Në bazë të

⁹ Intervista me Z. Valon Prestreshi, President i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, 24 korrik 2018

¹⁰ Ligji për Ndihmë Shtetërore nr. 05/L-100

¹¹ Intervista me Z. Agim Krasniqi, Drejtor i Departamentit për Ndihmë Shtetërore, Ministria e Financave, 24 gusht 2018

¹² Ligji për Ndihmë Shtetërore nr. 05/L-100

agjendës së Kuvendit, procedura e emërimit pasues do të vazhdoj menjëherë pas ri mbledhjes së Kuvendit për funksionet e tyre të përditshme.¹³ Pasi që emërimi i anëtarëve të Komisionit ende deri më tash nuk ka përfunduar, për këtë arsye, zbatimi efektiv i Ligjit për Ndhmë Shtetërore ka mbetur për tu demonstruar. Në bazë të Raportit Shtetëror nga BE, Departamentit për Ndhmë Shtetërore aktualisht nuk ka kapacitet që ti realizoj përgjegjësitë e veta, gjegjësisht të kontrolloj skemat ekzistuese të ndihmave, sikur është përcaktuar në MSA.¹⁴ Për këtë arsye, kapaciteti aktual për zbatimin e Ligjit për Ndhmë Shtetërore nuk mund të vlerësohet derisa nuk emërohen anëtarët e Komisionit për ndihmë Shtetërore.

AKK: Përgjegjësitë dhe rastet e hetuara

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, për të siguruar konkurrencën e lirë dhe efektive në treg, përqendrohet në tri shtylla kryesore; shpërdorimi i Pozitës Dominuese, krijimi i marrëveshjeve të ndaluara në formë të karteleve dhe shkrijet apo përqendrimet e ndërmarrjeve.¹⁵ AKK ka të drejtë të ofroj mendim profesional sa i përket kornizës ligjore e cila rregullon konkurrencën si dhe në pajtueshmërinë e legjislacionit ekzistues me “EU acquis”; ngritja e vetëdijes për konkurrencë duke këmbyer informata dhe njohuri; dhe krahasimi i praktikave ligjore dhe politikave të konkurrencës së tregut kur kërkohet nga Kuvendi dhe Qeveritë lokale apo qendrore.¹⁶ Në përputhje me ligj, AKK duhet të lëshoj vendime të veçanta kur bën vlerësimin e marrëveshjeve me vlera të vogla, duke përcaktuar shpërdorimin e pozitave dominuese dhe shqiptimin e sanksioneve administrative për shkeljet, vlerësimin e pranueshmërisë së shkrijes/përqendrimit, identifikimin e masave për rivendosjen e konkurrencës dhe përcaktimin e masave të nevojshme për ndërmarrjet të cilat nuk u binden vendimeve të AKK-së. Për më shumë, AKK mund të realizoj inspektime pa paralajmërim në biznese dhe të dokumenteve të tyre relevante, dhe nëse është e nevojshme, sekuestrimin e gjësendeve me interes, me aprovim juridik.¹⁷

Tabela 2: AKK rastet/vendimet 2016-2018

Viti → Vendimet↓	2016 (qer-dhje)	2017	2018 (jan-korr)	Totali
Kartelet	1	11	4	16
Pozita Dominuese	0	1	2	3
Përqendrimet	1	2	5	8
Mendimet profesionale	2	5	0	7
Totali	4	19	11	34

Burimi: të dhënat e nxjerra nga ueb faqja e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës

¹³ Koha Net (2018). “Kuvendi përgatitet për pushime, ligjet barten për miratim në vjeshtë” [Online] 7 korrik 2018. Qasja në:

<https://www.koha.net/arberi/103789/kuvendi-pergatitet-per-pushime-ligjet-barten-per-miratim-ne-vjeshte/> [I futur më: 26 gusht 2018]

Zakonisht gjatë gushtit Kuvendi i Kosovës është në pushim

¹⁴ Komisioni Evropian. (2018). Raporti i Kosovës 2018. Dokument Pune i Personelit të Komisionit. Qasja në:

<https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-kosovo-report.pdf> [I futur më: 22 Aug 2018]

¹⁵ Autoriteti Kosovar i Konkurrencës. Misioni. [Online] Qasja nga: <http://ak.rks-gov.net/?cid=2,2> [I futur më: 12 korrik 2018]

¹⁶ Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës nr. 03/L-229, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-226, neni 23, par. 1 dhe 2

¹⁷ Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës nr. 03/L-229, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-226, neni 54

Sa i përket rasteve të trajtuara dhe vendimet e lëshuara nga ana e Autoritetit, që nga koha kur Komisioni ka rifilluar punën e tij (qershor 2016), kishte 34 raste të trajtuara, përfshirë mendimet profesionale. Tabela më sipër paraqet numrin e rasteve në kategori të ndryshme të hetuara nga qershori 2016 deri në korrik 2018, përderisa Kutia 1 ofron informata të detajuara lidhur me rastet. Sidoqoftë, vlen të përmendet që rastet e hetuara nga ana e Autoritetit dhe raportet vjetore për punën e tij që nga themelimi (2008) deri në qershor 2016 nuk janë në dispozicion publik.

Kutia 1: Rastet e hetuara nga Autoriteti

Në vitin 2016, autoriteti ka hetuar vetëm katër (4) raste:

- Kartelet (1) – Marrëveshja për fiksimin e çmimit të mjedrave në Podujevë;
- Përqendrimet (1) – Përqendrimet në mes të Phoenix Pharma DOOEL dhe Exclusive Pharma LLC;
- Mendim profesional (2) – Limak (Limited Ground Handling Service Incentive/ Stimulimi për Shërbimet e Trajtimit të Kufizuar Tokësor), dhe Ministria e Punëve të Brendshme dhe Moneta (marrëveshjet e ndaluara).

Në vitin 2017, Autoriteti i ka hetuar një numër të madh të rasteve, duke arritur në numrin 19 të tyre:

- Kartelet (11) – Marrëveshjet e fiksimit të çmimit në Lipjan, Pejë dhe Mitrovicë, ankesa për cenimin e veprimtarisë së Postës së Kosovës, marrëveshja për fiksimin e çmimit për përpunimin dhe shitjen e grurit në Kosovë, konkluzionet mbi autorizimin e organeve për vlerësimin e pajtueshmërisë, vendimi për fushën e rezervuar nga operatorët e marketeve në Kosovë, në Trust kundër operatori ekonomik i sigurimeve (Vienna Insurance, Siguria), tenderimi i shërbimeve dhe mirëmbajtja e automjeteve (Ministria e Drejtësisë kundër kompanive ofertuese), shkelje e konkurrencës (VIVA Fresh Store kundër Komunes së Suharekës), dhe kërkesa për marrjen e licencës për ujin termo-mineral (Visar Turkaj);
- Pozita dominuese (1) – Abuzimi me Pozitë Dominuese (Liridon Aliu kundër ‘24 Yjet’ kompania)
- Përqendrimet (2) – British American Tobacco dhe Bulgar Tabac Holding, dhe CDC- Kosovo dhe Emona City;
- Mendim Profesional (5) – Korrigjimi i dispozitës së vendimit, nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit për distribuimin e skemës së pagesave për asistencë sociale në mes të MLSË-BPB-PK, ankesë nga Railtrans enterprise kundër NP Trainkos për ofrimin e shërbimeve, vlerësimi i Ligjit nr. 05 / L-132 për automjetet dhe draft-udhëzimi i administrativ për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për homologimin e automjeteve.

Nga janari - korrik 2018, Autoriteti ka hetuar dhe lëshuar vendime për 11 raste:

- Kartelet (4) – Marrëveshjet e fiksimit të çmimit në Pejë, konkluzionet për marrëveshje të ndaluar apo praktikata e orkestruara të ndërmarrjeve në tenderët e Ministrisë së Shëndetësisë, shkelja e Ligjit për Konkurrencë (IPKO kundër VALA dhe Z-Mobile), dhe shkelja e mundshme e konkurrencës së tregut (IPKO dhe Digit Alb, SH.A);
- Pozita dominuese (2) – Konkluzionet për shpërdorim të Pozitës Dominuese të shërbimeve funerale (operatorë të ndryshëm ekonomik kundër BIK) dhe shpërdorimi i Pozitës Dominuese në tregun e shërbimeve të kabllorit digjital (Grupi Koha kundër IPKO telecommunications);
- Përqendrimet (5) – kërkesë për njoftim të përqendrimit dhe vendim për përqendrim në

mes të NewCo Ferronikeli Complex LLC dhe NKL Limited, kërkesë për njoftim të përqendrimit dhe vendim për përqendrim në mes të Neregelia Trading Ltd/Beta Group dhe All Balcans Corporation, dhe kërkesë për njoftim të përqendrimit në mes të American Hospital dhe Hygeia Hospital.

Autoriteti ka neglizhuar sektorët kryesor të karakterizuar me monopole dhe shpërdorim të Pozitës Dominuese për një kohë shumë të gjatë. Sidoqoftë, AKK ka marrë detyrë, sikur është theksuar nga Agjenda Evropiane e Reformës, të hetoj dhe të hartoj një raport për situatën aktuale të monopoleve në Kosovë. Deri në fund të vitit 2017, Autoriteti ka përpiluar një raport i cili ka theksuar gjetjet kryesore lidhur me strukturën e tregut të ndërmarrjeve dhe Pozitës së tyre Dominuese në 14 sektorë/tregje të ndryshme, përfshirë atë të telekomunikacionit, energjisë, sigurimeve, produkteve të naftës, farmaceutikëve, transportit, mediave dhe kinematografisë, prokurimit, bankave, pajisjeve fiskale, lojërave të fatit (bastoret), minierave, menaxhimit të mbeturinave dhe furnizimit me ujë. Raporti gjithashtu ofron rekomandimet për institucionet relevante dhe agjencitë e pavarura për këto 14 sektorë/tregje.¹⁸

Për të identifikuar rastet e Pozitave Dominuese dhe monopolet e sektorëve specifike, Autoriteti ka përdorur pjesën e qarkullimit vjetor të kompanisë specifike në proporcion me numrin total të qarkullimit vjetor të kompanive tjera në këtë sektorë. Në përputhje me ligjin, një kompani apo ndërmarrje e cila më shumë se 25 përqind të aksioneve të sektorit specifik konsiderohet të ketë Pozitë Dominuese.¹⁹ Analizat sugjerojnë që disa nga sektorët e hetuar nuk janë konkurrues, çështje kjo e situatës së monopolit por edhe e një kompanie të vetme e cila e gëzon një Pozitë të qartë Dominuese.²⁰ Duke marrë parasysh faktin që Autoriteti ka ofruar vetëm një raport preliminar të gjendjes aktuale, raportit i mungojnë detajet dhe analiza e thuktë dhe si e tillë, por edhe si një hetim i shpërdorimeve të mundshme të konkurrencës së drejtë. Për këtë, Autoriteti ka një rrugë të gjatë pranë vetes për të rregulluar këto tregje për ta siguruar një treg konkurrues dhe të lirë në Kosovë.

Pasi që raporti e ka limituar veten që të paraqes një pasqyrë të përgjithshme të 14 sektorëve të lartë përmendura, Autoriteti ka marrë detyrë që ti analizojë dhe hetojë thellësisht – deri në fund të vitit 2018 – dy sektorët kryesor të zhvillimit ekonomik në Kosovë, telekomunikacionin dhe homologimin.²¹ Sektori i telekomunikacionit përbëhet prej katër nën-sektorëve: linja (telefonike) fikse, mobile, ofrimi i internetit dhe shërbimet postare. Duhet të ceket se në të gjitha këto nën-sektorë, një ose dy kompani janë përcaktuar të gëzojnë një Pozitë Dominuese. Sidoqoftë, në bazë të Autoritetit, pavarësisht nëse kemi një apo më shumë operator ekonomik dominues, këto katër nën-sektorë të telekomunikacionit konsiderohen si përgjithësisht konkurrues ose konkurrues deri në një masë.²²

¹⁸ Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (2017) "Report on Performance of Duties Deriving from the European Reform Agenda". Prishtinë. Qasja në: <https://ak.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Report%20on%20ERA.pdf> [I futur më: 25 qershor 2018]

¹⁹ Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës no. 03/L-229, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-226, neni 10

²⁰ Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (2017) "Report on Performance of Duties Deriving from the European Reform Agenda". Prishtinë. Qasja në: <https://ak.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Report%20on%20ERA.pdf> [I futur më: 25 qershor 2018]

²¹ Intervista me Z. Valon Prestreshi, President i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, 24 korrik 2018

²² Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (2017) "Report on Performance of Duties Deriving from the European Reform Agenda". Prishtinë. Qasja në: <https://ak.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Report%20on%20ERA.pdf> [I futur më: 25 qershor 2018]

Tabela 3: Pozitat dominuese të kompanive në sektorin e telekomunikacionit

Nën-sektorët	Kompania	Pozita Dominuese (>25%)
Shërbimet e linjës fikse	Telekomi i Kosovës	80%
Shërbimet Mobile	Telekomi i Kosovës– Vala	59.8%
	Ipko Telecommunication LLC	32.6%
Ofrimi i Internetit	IPKO	48%
	Kujtesa Net	25%
Shërbimet postale	Posta e Kosovës	67.1%

Burimi: Adaptimet e autorit bazuar në raportin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës mbi performancën e detyrave të dala nga Agjenda Evropiane e Reformës

Homologimi, në anën tjetër, është nën-kategori e shërbimeve në kuadër të sektorit të transportit rrugor. Homologimi ka qenë njëra ndër temat shumë të debatuar dhe të zëshme nga ana e shoqërisë civile në Kosovë. Që nga viti 2009, Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit (tash Ministria e Infrastrukturës) ka nënshkruar një kontratë me një operator ekonomik - EuroLab -, duke i dhënë të drejtat ekskluzive që ti ofroj shërbime të homologimit për automjetet në Kosovë për një periudhë 10 vjeçare. Që nga atëherë, ky operator ekonomik, një monopol natyral, ka ngarkuar çmime shumë të larta nëse krahasohen me vendet e rajonit dhe të Evropës. Në të kundërtën, këto vende rregullojnë si duhet këtë sektor duke i dhënë mundësinë kompanive të ndryshme që të ofrojnë shërbime të homologimit dhe në të njëjtën kohë promovojnë konkurrencën e drejtë në treg.²³

Përmes kësaj kontrate, Ministria nuk i ka ofruar hapësirë operatorëve tjerë ekonomik që të ofrojnë shërbime të homologimit. Në vitin 2015, Qeveria Mustafa morri një vendim që të inicioj procedurat për eliminimin e të gjitha veprimtarive të cilat janë kundër konkurrencës së lirë, të tillë si krijimi apo shpërdorimi i Pozitës Dominuese, si dhe praktikave të cilat ndikojnë te qytetarët.²⁴ Pavarësisht këtij vendimi, situata e homologimit është përkeqësuar dhe më tutje kur Ministria e Infrastrukturës e ka hartuar Udhëzimin Administrativ nr. 2/2018 për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për homologimin e automjeteve, i cili e mëkëmbë liberalizimin e këtij sektori. Në lidhje me këtë, ky UA sugjeron që testi i automjeteve A-testi, i cili deri në vitin 2018 është realizuar nga Fakulteti i Shkencave Teknike në Universitetin e Prishtinës, do të ofrohet nga kompania e njëjtë e cila aktualisht ofron shërbimet e homologimit të automjeteve. Si pasojë e kësaj do të thellohet edhe më shumë monopoli ekzistues në këtë sektor, duke penguar operatorët tjerë ekonomik që të futen në treg.

Edhe pse Autoriteti ka rekomanduar me këmbëngulje te Ministra që ti rishikoj dispozitat e caktuara të Udhëzimit Administrativ në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, Ministria e ka miratuar atë më 12 prill të vitit 2018. Rrjedhimisht, Autoriteti e ka shprehur brengën e tij për mospërfilljen e plotë të rekomandimeve të tyre dhe ka kërkuar nga Ministria që menjëherë të konsideroj mendimin e tyre dhe ti ndryshojnë këto dispozita. Për më shumë, Autoriteti është i vendosur që ti përdorë të gjitha mjetet juridike dhe ta ngrit këtë çështje tek

²³ Pula, E., Elshani, D., dhe Ajeti, D. (2017) *The performance of the Autoritetit Kosovar të Konkurrencës*. Group for Legal and Political Studies (Grupi për Studime Juridike dhe Politike). Qasja në: <http://www.legalpoliticalstudies.org/ep-content/uploads/2017/10/GLPS-Policy-Report-AKK-Performance.pdf>

²⁴ Government of the Republic of Kosovo. Vendimi nr. 17/44. gusht 12, 2015. Qasja në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_44-te_te_Qeverise_se_Republikes_se_Kosoves_2015.pdf [I futur më: 20 qershor 2018]

institucionet relevante.²⁵ Përveç Autoritetit, përfaqësuesit e shoqërisë civile gjithashtu e kanë kundërshtuar miratimin e këtij UA i cili edhe më shumë e përkeqëson situatën e monopolit ekzistues në këtë sektor.²⁶

Bashkëpunimi

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës vazhdimisht ka provuar që ti krijoj marrëdhëniet e mira me autoritetet tjera të konkurrencës në rajon dhe më gjerë, për ti shkëmbyer ekspertizat, përvojat dhe praktikat më të mira të hetimeve të tregut. Në lidhje me këtë, në vitin 2018 AKK-ja i ka nënshkruar memorandumet e mirëkuptimit me autoritetet e konkurrencës nga Kroacia dhe Turqia. Qëllimi kryesor i këtyre MM-ve është që të fuqizohet efikasiteti i Autoriteteve përkatëse për shkëmbimin e informatave legislative, përvojave nga hetimet e rasteve, praktikat më të mira nga ekspertët, politikat për zbatimin e ligjit dhe të konkurrencës, si dhe organizimin e vizitave studimore nga të dyja palët dhe trajnimet dhe konsultimet për çështjet e ndryshme që kanë të bëjnë me konkurrencën. Bashkëpunimi i ngushtë në mes të këtyre autoriteteve pritet të çojë në drejtim të fuqizimit të marrëdhënieve bilaterale, pasi që konkurrenca e drejtë e tregut mbetet një nga shtyllat kritike të zhvillimit ekonomik. Sipas Kryetarit të Komisionit, Autoriteti është në proces të nënshkrimit të një memorandumi tjetër me Austrinë për fuqizimin e mëtejshëm të marrëdhënieve bilaterale dhe për shkëmbimin e përvojave bazuar në rastet e suksesshme të hetimeve të tregut.²⁷ Për më shumë, Autoriteti është duke përfituar nga projekti i binjakëzimit, i cili është financuar nga Bashkimi Evropian dhe i cili ka për qëllim të përkrahë institucionet e Kosovës në zbatimin e MSA-së.²⁸

Në kontekstin rajonal, do të krijohet një nën-komision për konkurrencë nga ana e shteteve anëtare të CEFTA-s përmes një memorandumi rajonal. Qëllimi i kësaj është që të krijohet një program rajonal online për shkëmbimin e bazave të të dhënave në mes të vendeve të CEFTA-s, me synim të shkëmbimit të përvojave dhe procedurave që lidhen me hetimin e rasteve të konkurrencës. Ky memorandum pritet të finalizohet deri në fund të këtij viti.²⁹ Si rezultat i kësaj, do të kemi një kontribut pozitiv për teknikat hetuese të AKK-së.

Sfidat/Çështjet me të cilat është përballur Autoriteti

AKK-ja është përballur me disa sfida të cilat kanë ndikuar negativisht dhe kanë penguar punën dhe performancën e tij.

- Së pari, Mendimet Profesionale të ofruara nga Autoriteti jo gjithnjë konsiderohen relevante për institucionet, siç ishte rasti me atë të homologimit të automjeteve. Pavarësisht paralajmërimeve të përsëritura nga Autoriteti, Ministria ka vazhduar tutje me UA dhe e ka rënduar edhe më shumë situatën monopoliste tashmë të identifikuar.
- Së dyti, Autoriteti rrallë herë konsultohet nga ana e institucioneve tjera kur ato bëjnë hartimin, ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve dhe rregulloreve të cilat ndikojnë fushën e

²⁵ Deklaratë për shtyp. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës. 25 prill, 2018.

²⁶ Osmani, T. (2018) "Trashja e monopolit në homologim" [Online] Kallxo.com 18 maj 2018. Qasja në: <https://kallxo.com/gjnk/trashja-e-monopolit-ne-homologim/> [I futur më: 5 korrik 2018]

Deri në miratimin e këtij UA, EuroLab ka pasur një monopol për homologimin e automjeteve, inspektimin e parë teknik (shkelje e Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit), dhe mbikëqyrjen e qendrave për inspektimin teknik të automjeteve.

²⁷ Intervista me Z. Valon Prestreshi, President i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, 24 korrik 2018

²⁸ Ibid

²⁹ Ibid

konkurrencës. Kjo rezulton në një konflikt/mospërputhje të mundshme në mes të ligjeve ekzistuese dhe atyre të reja.

- Së treti, gjyqtarët të cilët trajtojnë rastet e konkurrencës kanë mungesë të ekspertizave adekuate për këtë fushë, ku rrjedhimisht i zvarrisin procedurat. Për më shumë, gjykata ka tendencë që të përqendrohet më shumë në çështje procedurale, duke lënë anash substancën e rasteve.³⁰

3. Konkurrenca nën MSA

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) është marrëdhënie e parë kontraktuale në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian, në kuadër të kornizës së punës së PSA-së, e cila hap rrugë drejt integritimit Evropian për vendet e Ballkanit Perëndimor. MSA-ja ngërthen kapitujt e ndryshëm, përfshirë dialogun politik, bashkëpunimin rajonal, lëvizjen e lirë të mallrave, përafrimin me “EU Acquis”, zbatimin e ligjit dhe rregullat e konkurrencës, liritë, sigurinë dhe drejtësinë, si dhe bashkëpunimin financiar.

Përmes MSA-së, institucionet e Kosovës duhet të zbatojnë një sërë reformash në kuadër të një periudhe të caktuar kohore. Sa i përket kësaj, për ta shtyrë këtë proces të rëndë përpara dhe për të korrur të gjitha përfitimet të cilat dalin nga marrëveshja, zbatimi i MSA-së mbështetet në dy kornizat kryesore: Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA), dhe Planin e Veprimit për Zbatimin e Prioriteteve Kyçe të dala nga ARE.

a) Metodologjia e Monitorimit

Objektivi kryesor i këtij studimi është që të vlerësohet dhe monitorohet performanca e institucioneve Kosovare në drejtim të plotësimit të kriterëve të cilat dalin nga MSA-ja, me fokus të veçantë në monitorimin e arritjeve të masave dhe prioritete të cilat bien nën fushën e konkurrencës, të identifikuara në PKZMSA dhe ARE. Institucionet relevante janë kontaktuar përmes emailit, telefonit apo në takime ballë-për-ballë. Institucionet të cilat janë monitoruar kanë përfshirë Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, Agjencinë e Statistikave, Kuvendin e Kosovës, Zyrën e Kryeministrit dhe Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe Zhvillimit Ekonomik.

Rezultatet e monitorimit, të paraqitura në Tabelën e Vlerësimit më poshtë, theksojnë përparimin (progresin) dhe sfidat e mbetura të institucioneve relevante nga janari e deri në qershor të vitit 2018. Më saktësisht, Tabela e Vlerësimit kategorizon përparimin e masave dhe treguesve në pesë kategori: a) të plotësuar, b) pjesërisht të plotësuar, c) të pa plotësuar, d) Në zhvillim e sipër, dhe e) nuk janë ofruar informata.³¹

b) Rezultatet e Monitorimit - PKZMSA

Prioritetet e PKZMSA 2018-2022, rishtazi të rishikuara, të afatit të shkurtër dhe të mesëm, janë të kategorizuar në tri blloqe kryesore: Kriteret Politike, Kriteret Ekonomike dhe Standardet Evropiane – Përafrimi i Legjislacionit Kosovar me “EU Acquis”. Blloku i fundit III, përfshinë një llojllojshmëri të politikave publike të cilat kërkohet që të reformojnë krejt qeverinë përmes harmonizimit të legjislacionit kombëtar me “EU Acquis”, i përcjellë me kapacitetet e nevojshme

³⁰ Intervista me Z. Valon Prestreshi, President i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, 24 Korrik 2018

³¹ d) Në zhvillim e sipër – të gjitha masat e parapara të përfundohen gjatë çerekut 3 apo 4 të vitit.

e) Kur nuk ofrohen informata nga institucionet relevante, masat dhe treguesit e tillë klasifikohen si ‘nuk janë ofruar informata’.

administrative. Blloku i tretë përbehet prej 36 kapitujve, përfshirë një për Politikën e Konkurrencës.³² Në përgjithësi, ky Kapitull përqendrohet në marrëveshjet në mes të ndërmarrjeve, shpërdorimit të Pozitës Dominuese dhe shkrirjet dhe përqendrimet.³³ Marrë parasysh këtë, PKZMSA ka paraparë disa objektiva afat shkurtra dhe afat-mesme për tu plotësuar nga institucionet relevante të cilat rregullojnë konkurrencën në treg.

PKZMSA 2017 ka paraparë një numër të Udhëzimeve Administrative relevante që kanë nevojë të lëshohen nga institucionet relevante, si nga Autoriteti Kosovar i Konkurrencës po ashtu edhe nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Të gjitha objektivat e MSA-së të parapara për vitin 2017 ishin plotësuar:

- Udhëzimi Administrativ për përjashtimin grupor të marrëveshjeve horizontale;
- Udhëzimi Administrativ për përjashtimin grupor të marrëveshjeve vertikale;
- Udhëzimi Administrativ për përjashtimin grupor të marrëveshjeve në sektorin e sigurimeve;
- Udhëzimi Administrativ për përjashtimin grupor të marrëveshjeve në sektorin e transportit, dhe
- Udhëzimi Administrativ për përjashtimin grupor të marrëveshjeve në sektorin e distribuimit dhe servisimit të automjeteve.

Në bazë të PKZMSA-së 2018, për të vazhduar përafrimin me *acquis* duhet të miratohen rregulloret në vijim:

- Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 03 / L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës,
- Udhëzimi Administrativ për përcaktimin e dënimeve, dhe
- Udhëzimi Administrativ për përcaktimin e tregut relevant.

Në bazë të Kryesuesit të AKK-së, procedurat për këto tri akte kombëtare janë iniciuar dhe janë në procedim, të parapara të përfundohen deri në çerekun e 4të të vitit 2018.³⁴

Ngjashëm, akti rregullator lidhur me Ndhmën Shtetërore i cili duhet të harmonizohet me “EU *acquis*” deri në fund të vitit 2018, është ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për Procedurat dhe Formatin e Njoftimit për Ndhmën Shtetërore. Departamenti për ndihmën Shtetërore tashmë ka përfunduar draftin e këtij akti rregullues i cili është dërguar te institucionet relevante për procedurat e mëtejshme të miratimit.³⁵

c) Rezultatet e monitorimit – ARE

Agjenda e Reformave Evropiane është një dokument i hartuar nga Qeveria e Kosovës dhe Komisioni Evropian me qëllim të përkrahjes dhe përsheptimit të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. ARE, i përbërë nga prioritetet afat-shkurtra me qëllim të maksimizimit të përfitimeve ekonomike dhe politike nga MSA-ja, është i përbërë nga tri fushat kryesore: Sundimi i Ligjit dhe Qeverisja e Mirë, Konkurrueshmëria dhe Klima e Investimeve, Punësimi dhe Arsimi. Për qëllim të studimit, në kemi monitoruar nga afër zbatimin e shtyllës së dytë - Konkurrueshmëria dhe Klima e Investimeve.

³² Blloku III përbëhet nga një kapitull për kornizën ligjore për përafrimin e legjislacionit

³³ Programi Kombëtar për Zbatimin e marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA) 2018 – 2022. Maj 2018. Prishtinë

³⁴ Intervista me Z. Valon Prestreshi, President of the Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, 27 gusht 2018

³⁵ Intervista me Znj. Antoneta Shtufi Gojani, Zyrtare e Lartë për Kontrollimin e Vëzhgimit të Ndhmës Shtetërore, Departamenti i Ndhmës Shtetërore, 21 gusht 2018

Fillimisht, shtylla e Konkurrueshmërisë dhe Klimës së Investimeve ka qenë e përbërë nga shtatë (7) masat, të zërthyer në 75 veprime dhe tregues. Prioritetet përfshijnë:

- Promovimin e investimeve të huaja direkte;
- Përmirësimin e mjedisit afarist;
- Zbatimin sistematik të strategjisë së miratuar dhe planit të veprimit për të luftuar ekonominë joformale;
- Mbështetjen për zhvillimin e NVM-ve;
- Zhvillimin e mëtejshëm të një numri statistikash sektoriale që janë kyçe për bërjen e politikave në fushën e llogarive kombëtare, statistikave tregtare dhe atyre afariste, të energjisë dhe atyre sociale;
- Përmirësimin e ndërlidhshmërisë rajonale;
- Përmirësimin e sigurisë së energjisë dhe miratimin e një strategjie gjithëpërfshirëse të energjisë për periudhën 2017-2026.³⁶

Gjatë vitit 2017, rezultatet e monitorimit për shtyllën e Konkurrueshmërisë dhe Klimës së Investimeve ka treguar se janë plotësuar 32.9 përqind të veprimeve dhe treguesve, 53.7 përqind janë plotësuar pjesërisht dhe 13.4 përqind nuk janë plotësuar. Sa i përket fushës së konkurrencës, masat kryesore për institucionet relevante ka qenë që ti përafrojnë dhe përforcojnë kapacitetet e Autoritetit të Konkurrencës si dhe organet e Ndihmës Shtetërore, të përbërë prej katër (4) indikatorëve:

- a) Fuqizimi i procedurave dhe kapaciteteve të brendshme në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës për realizimin e hetimeve – Ky tregues ka qenë pjesërisht i plotësuar në vitin 2017. AKK-ja vazhdimisht ka kërkuar një rritje të buxhetit, veçanërisht në kategorinë e pagave dhe mëditjeve. Kjo kërkesë është miratuar për buxhetin e vitit 2018, gjë e cila ndikojë që AKK-ja të rris numrin e personelit duke i punësuar katër punonjës. Për këtë, ky tregues është plotësuar plotësisht në vitin 2018.
- b) Hulumtimi dhe përgatitja e një raporti mbi gjendjen aktuale të monopoleve në tregun në Kosovë, me rekomandimet e duhura nga Autoriteti i Konkurrencës – Ky tregues është plotësuar plotësisht në vitin 2017. AKK-ja ka përpiluar një raport i cili thekson gjendjen e punëve në fushën e konkurrencës, vlerëson strukturën e tregut të ndërmarrjeve dhe ndonjë situatë të Pozitës Dominuese për 14 sektorët/tregjet e ndryshme. Raporti gjithashtu ofron rekomandime për institucionet relevante dhe agjencitë e pavarura, si dhe është dorëzuar në Kuvend, Qeveri dhe Komisionin Evropian.
- c) Përafrimi dhe ndryshimi ligjit për ndihmë shtetërore dhe përafrimi i legjislacionit sekondar – Ky tregues është plotësuar plotësisht në vitin 2017. Projekt-ligji për Ndihmën Shtetërore është miratuar nga ana e Qeverisë në maj të vitit 2016, dhe ka kaluar si Ligj në Kuvend në dhjetor të vitit 2016. Ligji për Ndihmën Shtetërore pastaj ka hyrë në fuqi pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare në janar 2017.
- d) Ligji për Ndihmë Shtetërore siguron pavarësisë operative dhe kapacitet e mjaftueshme për të përmirësuar efikasitetin e kontrollit të tij në ndihmën shtetërore – Ky tregues është plotësuar plotësisht në vitin 2017. Ligji për Ndihmën Shtetërore parasheh që Komisioni për Ndihmën Shtetërore duhet të jetë i përbërë nga pesë (5) anëtarë, ekspert të pavarur në fushën e ndihmës shtetërore për një afat kohorë prej tri (3) vjetësh.

³⁶ Agjendën e Reformave Evropiane (ARE) (2016) Kosovë – Dialogu i Nivelit të Lartë me BE për Prioritetet Kyçe. Prishtinë. Qasja në: https://www.meiks.net/repository/docs/era_final.pdf [I futur më: 12 Korrik 2018]

Sa i përket vitit 2018, shtylla e dytë - Konkurrueshmëria dhe Klima e Investimeve – përbëhet nga 12 masa të formuara në pesë (5) grupe të kategorive të ndryshme: promovimin e investimeve të huaja direkte, përmirësimin e mjedisit afarist, statistikat, agjenda e ndërlidhshmërisë dhe energjia. Këto 12 masa janë të zbërthyera në 44 veprime dhe tregues, që gjenden në pesë kategoritë e përmendura. Rezultatet e monitorimit tregojnë që 38.64 përqind të masave dhe treguesve ishin *plotësuar*, 11.36 përqind janë *plotësuar pjesërisht*, 13.63 përqind *nuk janë plotësuar*, dhe 36.36 përqind të tyre janë ende *në zhvillim e sipër* të cilat duhet të plotësohen në çerekun e 3-të apo të 4-të të vitit 2018. Duhet të ceket se gjatë kësaj faze të monitorimit institucionet relevante që i takojnë shtyllës së dytë (2) ishin bashkëpunuese dhe kanë ofruar informatat e kërkuara për përparimin e çdo mase; si rrjedhojë, nuk ka kategori e cila është cilësuar si '*nuk janë ofruar informata*'. Pasi që veprimet dhe treguesit të cilët *nuk janë plotësuar* dhe *janë plotësuar pjesërisht* përbëjnë 25 përqind të të gjitha masave të shtyllës së dytë (2), duhet të ketë një përkushtim më i madh dhe dëshirë nga institucionet relevante për të plotësuar masat dhe përshpejtuar procesin e zbatimit të MSA-së.

Gjatë procesit të monitorimit, institucionet relevante kanë arritur që të miratojnë Ligjin për Kontabilitetin, Raportim Financiar dhe Auditim, Strategjinë për Energji 2017-2026, përmirësojnë prodhimin dhe publikimin e statistikave afat-shkurtra të bizneseve dhe, në mes tjerash, të përmirësojnë publikimin e rezultateve statistikore për Anketën për Fuqinë Punëtore. Për një përparim të detajuar të çdo mase të cilat i takojnë kësaj shtylle, referohuni në tabelën e vlerësimit më poshtë.

Sidoqoftë, edhe pse ARE konsiderohet si një mjet për zbatimin e suksesshëm të Marrëveshjes, rezultatet e monitorimit për vitin 2018 tregojnë që institucionet nuk janë përkushtuar plotësisht arritjes së të gjithë treguesve të paraparë për këtë periudhë. Më saktësisht, institucionet relevante kanë dështuar që të ristrukturojnë Agjencinë Kosovare për Promovimin e Investimeve, ti zhvillojnë kapacitetet e saja dhe të themelojnë bordin këshillues në kuadër të saj; të funksionalizojnë Komisionin për Ndihmën Shtetërore; dhe të krijojnë fonde për efikasitetin e energjisë.

TABELA 4: VLERËSIMI I ARE-së

I. PROMOVIMI I INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE

A. RISTRUKTURIMI I AGJENCISË PËR INVESTIME DHE PËRKRAHJEN E NDËRMARRJEVE NË KOSOVË – KIESA;			
PËRGJEGJËSI	MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIJË	MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIJË	MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIJË
VEPRIMI	A.1) Ristrukturimi i KIESA për t'i mundësuar që të përmbush me efikasitet përgjegjësitë e saj dhe të zbatojë prioritetet, ndarjen e burimeve të duhura dhe rekrutimin e punonjësve të kualifikuar.	A.2) Zhvillimi i kapaciteteve të personelit të KIESA për dizajnimin dhe zbatimin e shërbimeve dhe programeve.	A.3) Themelimi i Bordit Këshillues në kuadër të KIESA me pjesëmarrjen e komunitetit biznesor dhe përfshirjen e fuqishme të Zyrës së Kryeministrit.
GJENDJA	OBJEKTIVË JO E ARRITUR	OBJEKTIVË JO E ARRITUR	OBJEKTIVË JO E ARRITUR
PËRFUNDIMI	K1 2018	K1 2018	K1 2018
PUNA E BËRË	<u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) mbetet t'i propozojë Qeverisë strukturën organizative të KIESA-së, e cila është paraparë të bëhet bashkë me Rregulloren për organizimin e brendshëm të MTI-së ashtu si edhe është dakorduar në takimin e Këshillit Ministror për Integrim.	<u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Si rezultat i ngecjeve me çështjen e ristrukturimit të KIESA-së zhvillimi i kapaciteteve të personelit të KIESA-së për dizajnimin dhe zbatimin e shërbimeve dhe programeve nuk mund të bëhet.	<u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Draft lista e anëtarëve të Ekipit të Kosovës (Team Kosova) dhe Bordit Konsultativ të KIESA-s është përgatitur dhe dërguar për miratim tek Ministri. MTI-ja mbetet të dërgojë në Qeveri për miratim projektvendimin për themelimin e Bordit Këshillëdhënës.

B. MIRATIMI I AFTER-CARE PROGRAMIT DHE SHËRBIMEVE PËR INVESTITORËT	
PËRGJEGJËSI	MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIJË
VEPRIMI	B.1) Përgatitja dhe fillimi i zbatimit të shërbimeve dhe programeve të kujdesit pasues për investitorët
GJENDJA	OBJEKTIVË NË PROGRES
PËRFUNDIMI	K1 2018
PUNA E BËRË	<u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u>

Miratimi i këtij programi sipas rekomandimeve nga analiza është paraparë të bëhet më 30 shtator 2018. Mirëpo, pa finalizuar ristrukturimin e agjencisë, as ky program nuk mund të miratohet.

II. PËRMIRËSIMI I MJEDISIT AFARIST

C. MIRATIMI I LIGJIT PËR RAPORTIM FINANCIAR, KONTABILITET DHE AUDITIM

PËRGJEGJËSI	KUVENDI
VEPRIMI	C.1) Miratimi i Ligjit për Raportim Financiar, Kontabilitet dhe Auditim nga Kuvendi
GJENDJA	OBJEKTIVË E ARRITUR
PËRFUNDIMI	K1 2018
PUNA E BËRË	<u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Miratimi i Ligjit nga Kuvendi është bërë më 30 mars 2018. Kuvendi e ka parë si të arsyeshme që ligji të hyjë në fuqi në janar 2019, që do të thotë është shkelur afati i paraparë për hyrjen e ligjeve të reja në fuqi.

D. PËRDITËSIMI I REGJISTRIT QENDROR PËR LEJE DHE LICENCA

PËRGJEGJËSI	ZYRA E KRYEMINISTRIT	ZYRA E KRYEMINISTRIT
VEPRIMI	D.1) Formularët për leje/licenca janë dërguar për përkthim në shqip dhe anglisht	D.2) Ngjarje promovuese për versionin e përditësuar të këtij regjistri janë organizuar
GJENDJA	OBJEKTIVË E PA ARRITUR	OBJEKTIVË PJESËRISHT E ARRITUR
PËRFUNDIMI	K2 2018	K2 2018
PUNA E BËRË	<u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Regjistri online, https://lejelicenca.rks-gov.net , është i përkthyer në të tri gjuhët, shqip, serbisht dhe anglisht si dhe ka informacione për të gjitha lejet, licencat dhe tarifat.	<u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Ngjarjet për të promovuar versionin e azhurnuar të regjistrit elektronik për leje licenca varen nga agjenda e Kryeministrit dhe përfaqësuesve të Bankës Botërore, por pritet të mbahen në tremujorin e radhës.

E. MIRATIMI I LIGJIT PËR INSPEKTIVE

PËRGJEGJËSI	QEVERIA	MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË	MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË
VEPRIMI	E.1) Miratimi i Koncept dokumentit nga Qeveria	E.2) Ligji për inspektimet e përgjithshme i hartuar	E.3) Konsultimet publike me shoqërinë civile dhe akterët tjerë relevant janë mbajtur
GJENDJA	OBJEKTIVË E ARRITUR	OBJEKTIVË NË PROGRES	OBJEKTIVË NË PROGRES
PËRFUNDIMI	K3 2018	K3 2018	K3 2018
PUNA E BËRË	<u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Koncept dokumenti është hartuar nga grupi ndërmintor dhe është miratuar nga qeveria më 9 mars 2018.	<u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Grupi punues gjatë gjashtë muorit të parë ka hartuar vetëm koncept dokumentin. Ky veprim parashihet të përfundoj në tre mujin e tretë të 2018.	<u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Grupi punues gjatë gjashtë muorit të parë ka hartuar vetëm koncept dokumentin. Ky veprim parashihet të përfundoj në tre mujin e tretë të 2018.
PËRGJEGJËSI	QEVERIA	KUVENDI	
VEPRIMI	E.4) Miratimi i Projektligjit nga Qeveria	E.5) Miratimi i Projektligjit nga Kuvendi	
GJENDJA	OBJEKTIVË NË PROGRES	OBJEKTIVË NË PROGRES	
PËRFUNDIMI	K3 2018	K3 2018	
PUNA E BËRË	<u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Grupi punues gjatë gjashtë muorit të parë ka hartuar vetëm koncept dokumentin. Ky veprim parashihet të përfundoj në tre mujin e tretë të 2018	<u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Grupi punues gjatë gjashtë muorit të parë ka hartuar vetëm koncept dokumentin. Ky veprim parashihet të përfundoj në tre mujin e tretë të 2018	

F. MIRATIMI I LEGJISLACIONIT SEKONDAR PËR NDIHMË SHETËRORE DHE FUNKSIONALIZIMI I KOMISIONIT DHE DEPARTAMENTIT PËR NDIHMË SHETËRORE

PËRGJEGJËSI	MINISTRIA E FINANCAVE	MINISTRIA E FINANCAVE	KUVENDI
VEPRIMI	F.1) Miratimi i legjislacionit sekondar për ndihmë shtetërore	F.2) Funkcionalizimi i Departamentit për Ndihmë Shtetërore	F.3) Funkcionalizimi i Komisionit për Ndihmë Shtetërore
GJENDJA	OBJEKTIVË PJESËRISHT E ARRITUR	OBJEKTIVË E ARRITUR	OBJEKTIVË E PA ARRITUR
PËRFUNDIMI	K2 2018	K2 2018	K2 2018

PUNA E BËRËZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018

Gjatë kësaj periudhe kohore janë draftuar dy rregullore: draft-rregullorja për procedurat e njoftimit të Ndhmës Shtetërore dhe draft-rregullorja për punën e Komisionit të Ndhmës Shtetërore. Draft-rregullorja për Procedurat dhe Formatin e Njoftimit për Ndhmë Shtetërore e finalizuar nga Grupi Punues dhe tashmë gjendet në Departamentin Ligjor për konsultimet finale para se të del në konsultime publike.

ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018

Është emëruar Drejtori i Departamentit të Ndhmës Shtetërore dhe departamenti është kompletuar me staf në maj 2018. Funksionet e Departamentit të ndihmës shtetërore janë të rregulluara me nenin 8 të Ligjit nr.05/L-100 për Ndhmën Shtetërore.

ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018

Komisioni për Ndhmë Shtetërore duhet të emërohet nga Kuvendi dhe ligji parasheh që të përbëhet nga pesë anëtarë të cilët nuk janë aktivë në politikë me një mandat tre vjeçar. Konkursi për përzgjedhjen e kandidatëve është shpallur në korrik 2018, pra pas tremujorit të dytë të 2018-ës.

G. ZBATIMI I PLANIT TË VEPRIMIT PËR TË LUFTUAR EKONOMINË JOFORMALE

PËRGJEGJËSI	MINISTRIA E FINANCAVE	MINISTRIA E FINANCAVE	MINISTRIA E FINANCAVE
VEPRIMI	G.1) Realizohen vlerësime të pavarura sektoriale të rrezikut	G.2) Rishikohet/Miratohet Plani i Veprimit duke marrë parasysh të gjeturat nga vlerësimi i rrezikut	G.3) Përmirësohet më tej pajtueshmëria tatimore dhe zbatimi në mënyrë që të mbrohet interesi i fiskal i vendit
GJENDJA	OBJKTIVË E ARRITUR	OBJKTIVË E ARRITUR	OBJKTIVË E ARRITUR
PËRFUNDIMI	K3 2018	K3 2018	K3 2018
PUNA E BËRË	<u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Në vitin 2017 janë vlerësuar sektori i lojërave të fatit dhe sektori i ndërtimit dhe pasurive të paluajtshme. Ndërkaq, gjatë muajit qershor 2018 parashihet të përfundoj vlerësimi i rrezikut në sektorin e OJQ-ve duke kompletuar kështu tri vlerësime të rrezikut. Pas kryerjes së vlerësimit të rrezikut, grupi punues ka miratuar raportet përfundimtare dhe i ka dorëzuar për miratim në Ministrinë e Financave. Kjo objektivë vazhdon të realizohet, konsiderohet e arritur për këtë periudhë	<u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Në tetor 2017 u krijua Sekretariati i ri i Grupit të Përhershëm për Parandalimin e Ekonomisë Joformale. Raporti përfundimtar i vlerësimit të ekonomisë joformale së bashku me vlerësimet e rrezikut ka shërbyer për hartimin e planit të veprimit për vitin 2018 që u miratua në qershor të këtij viti. Këto të gjetura do të shërbejnë edhe për hartimin e strategjisë së re për luftimin e ekonomisë joformale dhe pastrimin e parave 2019-2024 që do të shqyrtohet gjatë 2018-ës.	<u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Për tremujorin e parë 2018, ka realizuar 7,084 vizita përmes të cilave ka lëshuar 555 gjoba mandatore. Gjithashtu ka pasur rreth gjysmë milioni euro ulje të kreditimit të TVSh-së dhe rreth 2 milionë euro zbritje të humbjes. Ndërsa për këtë periudhë janë realizuar 220 kontrolle dhe afro 9 milionë euro humbje e zbritur. Po ashtu ka realizuar 595 vizita tek bizneset e pa fiskalizuara dhe bizneset të cilat nuk lëshojnë kuponë fiskal me ç'rast janë shqiptuar 171 gjoba mandatore në vlerë rreth 35 mijë euro. Në tre muajt e parë ka pasur 46 aktivitete kundër shmangies tatimore, 29 intervista

kohore por nuk përfundon me kaq.

me të dyshuar dhe dëshmitarë, 67 konsultime me prokurorë dhe ka hapur 10 raste për dyshim të shmangies tatimore. Po ashtu janë këmbyer 22 informata të inteligjencës me NJIF, Policinë dhe Doganën e Kosovës.

PËRGJEGJËSI	MINISTRIA E FINANCAVE	MINISTRIA E FINANCAVE
VEPRIMI	G.4) Fuqizohet qasja ndër-institucionale dhe mekanizmat në fushën kundër pastrimit të parave, krimit financiar, financimit të terrorizmit dhe korrupsionit, përfshirë parandalimin, hetimet, vlerësimet dhe operimet	G.5) Raporte të rregullta tremujore, të përgatitura, konsultuara dhe publikuara
GJENDJA	OBJEKTIVË NË PROGRES	OBJEKTIVË E ARRITUR
PËRFUNDIMI	K3 2018	K3 2018
PUNA E BËRË	<p><u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u></p> <p>Numri i kërkesave për bashkëpunim ndërkombëtar është rritur si rezultat i anëtarësiminë organizatën EgmontGroup të Njësive të Inteligjencës Financiare gjatë vitit 2017, por edhe 2018. Si rrjedhojë, gjatë tremujorit të parë të 2018, NJIF ka pranuar 37 (IRD) kërkesa për informata nga agjencitë zbatuese të ligjit, ndërsa nga ana e NJIF-it, tek entitetet raportuese dhe agjencitë zbatuese të ligjit janë dërguar 69 (ORD) kërkesa për informacione. Ndërkombëtarisht janë pranuar 3 (IRI) kërkesa për informata dhe 3 (ORI) kërkesa për informata ka dërguar NJIF tek homologët ndërkombëtar. Kështu, NJIF ka lëshuar një urdhër për ngrirje në shumë prej afro 230 mijë euro dhe 26 mijë dollarë amerikan ndaj një kompanie vendore. Po ashtu kanë marrë pjesë në takime</p>	<p><u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u></p> <p>Raportimi tre-mujor nga Ministria e Financave është dashur të fillojë në vitin 2017. Kjo objektive është shtyrë që të finalizohet deri në fund të muajit shtator 2018. Megjithëkëtë, sipas raportimit në MIE, raportet për vitin 2015 dhe 2016 janë përgatitur dhe publikuar në ueb-faqen e Ministrisë së Financave. Sipas ueb faqes së MF-së, raporti vjetor financiar 2017 është publikuar në prill. MF ka përpiluar edhe raportin tre-mujor financiar për periudhën janar-mars i publikuar në maj 2018, megjithëse më shumë se një muaj më vonë se përfundimi i tremujorit të parë. Pritet të shihet nëse edhe raportet tremujore të radhës do të publikohen me rregull.</p>

ndërkombëtare të ndërlidhura me vlerësime të rrezikut si dhe si anëtarë të EgmontGroup.

H. MIRATIMI I PAKOS LIGJORE PËR TË PËRMIRËSUAR INFRASTRUKTURËN DHE STANDARDET E CILËSISË, SI DHE FUNKSIONALIZIMI I KATËR LABORATORËVE TË METROLOGJISË

PËRGJEGJËSI	MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIJË	MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIJË	MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIJË	MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIJË
VEPRIMI	H.1) Avancimi dhe përditësimi i rregullt i ueb faqes	H.2) Organizimi i 10 punëtorive për informim të bizneseve dhe promovim të ueb faqes	H.3) Organizimi i 30 moduleve për zhvillim të kapaciteteve njerëzore sa i përket infrastrukturës dhe standardeve të cilësisë	H.4) Miratimi i 1,500 standardeve në fokus në zonën e harmonizuar
GJENDJA	OBJEKTIVË E ARRITUR	OBJEKTIVË NË PROGRES	OBJEKTIVË NË PROGRES	OBJEKTIVË NË PROGRES
PËRFUNDIMI	K3 2018	K3 2018	K3 2018	K3 2018
PUNA E BËRË	<p><u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Ueb-faqja e MTI-së është ridizajnuar dhe mbushur me të dhëna në 2017 dhe vazhdon të përditësohet në baza ditore edhe në 2018.</p> <p>Është një aktivitet në vazhdimësi.</p>	<p><u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Organizimi i 10 punëtorive ka filluar në 2016 dhe ka vazhduar në 2017, por nuk kanë përfunduar në tremujorin e katërt të vitit të fundit megjithëse me marrëveshjen me BE-në ashtu ishte paraparë. Në maj dhe qershor 2018 janë mbajtur konferencë për shënimin e Ditës Botërore të Metrologjisë dhe manifestim për Ditën Botërore të Akreditimit.</p>	<p><u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Gjatë vitit 2018 zyrtarët e fushave relevante kanë marrë pjesë në trajnime apo takime pune të ndryshme jashtë vendit, si: Takime pune me institucionet e Infrastrukturës së Cilësisë, organizuar nga projekti Infrastruktura e Cilësisë në Vendet e Ballkanit Perëndimor, financuar nga SIDA në Stockhom, takime i Komitetit Drejtues të Projektit SIDA në Stockholmi, Forumi Regjional për Mbikëqyrjen e Tregut në Sarajevë, Trajnim në lidhje me zbatimin e ISO/IEC 17025:2017 (NE16) në Beograd, Konferencë</p>	<p><u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Gjatëgjatshëmujorit të parë të vitit 2018, Komitetet Teknike në kuadër të Agjencisë Kosovare për Standardizim (AKS) kanë adoptuar 544 standarde evropiane EN dhe ndërkombëtare ISO/IEC, të cilat janë adoptuar si standarde kosovare në fushat si ne vijim: 167 në Mjedis, 74 në Derivate të Naftës dhe Gazit, 1 në Metrologji si dhe 312 në elektroteknikë. Gjithsej për një vit e gjysmë janë miratuar 1191 standarde.</p>

për Metrologjinë ligjore (NE17)
në Beograd.

PËRGJEGJËSI	MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË	MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË	KUVENDI	MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË
VEPRIMI	H.5) Furnizimi i laboratorëve metrologjik ekzistues	H.6) Hartimi i Ligjit mbi shërbime dhe konsultimet me shoqërinë civile dhe akterë tjerë relevant	H.7) Miratimi i Ligjit mbi shërbime	H.8) Themelimi dhe funksionalizimi i pikës së vetme të kontaktit për shërbime
GJENDJA	OBJEKTIVË NË PROGRES	OBJEKTIVË E ARRITUR	OBJEKTIVË E ARRITUR	OBJEKTIVË NË PROGRES
PËRFUNDIMI	K3 2018	K3 2018	K3 2018	K3 2018
PUNA E BËRË	<u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Ka përfunduar furnizimi me pajisje për 6 laboratorë, atë të presionit, metaleve të çmuara, forcës, matjen e temperaturës dhe lagështisë relative, si dhe laboratorin e kohës dhe frekuencës. Gjithashtu është realizuar edhe trajnimi dy ditor për aftësimin e stafit për përdorimin e laboratorëve në fjalë. Në baza vjetore është duke u bërë furnizimi me pajisje të laboratorëve metrologjik ekzistues. Për vitin 2018, është shpallur tenderi për furnizim me pajisje laboratorike dhe se shpejti pritet të bëhet hapja e ofertave.	<u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Hartimi i projektligjit për shërbime, konsultimet dhe miratimi i tij janë kryer gjatë vitit 2017. Ligji është miratuar dhe publikuar në gazetën zyrtare me 3 prill 2017.	<u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Hartimi i projektligjit për shërbime, konsultimet dhe miratimi i tij janë kryer gjatë vitit 2017. Ligji është miratuar dhe publikuar në gazetën zyrtare me 3 prill 2017.	<u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Udhëzimi Administrativ për Mënyrën e Funksionimit të Pikës së Vetme të Kontaktit është hartuar në 2017, por është miratuar nga Qeveria më 16 mars 2018. Por, pika e vetme e kontaktit ende nuk është funksionalizuar.

I. ZBATIMI I PROKURIMIT ELEKTRONIK NË PROKURIMET E CENTRALIZUARA

PËRGJEGJËSI	MINISTRIA E FINANCAVE
VEPRIMI	I.1) Zbatimi i prokurimit elektronik në prokurimet e centralizuara vazhdon
GJENDJA	OBJEKTIVË E ARRITUR
PËRFUNDIMI	K3 2018

PUNA E BËRË ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018

Gjatë vitit 2017, janë zbatuar ndryshimet e ligjit të prokurimit në platformën elektronike, janë trajnuar e certifikuar zyrtarët në nivel lokal dhe qendror si dhe qeveria ka filluar publikimin e të dhënave standard të kontratave të prokurimit. Të gjitha veprimet e parapara janë përfunduar. Tenderimi në vlera të mëdha dhe të mesme është duke u kryer në mënyrë elektronike.

III. STATISTIKAT**J. ZHVILLIMI I STATISTIKAVE SEKTORIALE TË BIZNESIT, ENERGJISË DHE ATYRE SOCIALE**

PËRGJEGJËSI	AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS	AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS	AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
VEPRIMI	J.1) Vonesat e publikimit, të reduktuara për PBB-të vjetore dhe tremujore përkatëse dhe statistikave të logarive të qeverisë, përfshirë këtu publikimin në kohë të statistikave financiare të qeverisë me metodologjinë e ESA 2010	J.2) Prodhimi dhe publikimi i statistikave afatshkurtra të biznesit, të përmirësuara (vëllimit të prodhimit industrial dhe indekset e çmimeve)	J.3) Rezultatet nga statistikave të Anketës së Fuqisë Punëtore, të shpërndara në baza tremujore, dhe cilësia e tyre, e përmirësuar;
GJENDJA	OBJEKTIVË E ARRITUR	OBJEKTIVË E ARRITUR	OBJEKTIVË E ARRITUR
PËRFUNDIMI	K3 2018	K3 2018	K3 2018
PUNA E BËRË	<u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Aktualisht, BPV publikohet rregullisht në baza tremujore (kuartale) sipas metodologjisë së ESA2010 dhe sipas kalendarit të Eurostat-it (T+ 90 ditë). Po ashtu, afati për publikimin e BPV vjetore është shkurtuar. Llogaritë qeveritare për tremujorin e parë 2018 janë publikuar më 22 qershor 2018. Publikimet e mësipërme bëhen në përputhje me ESA 2010 ku metodologjia është zbatuar rreth 36%.	<u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Statistikat dhe publikimi i prodhimit industrial është dashur të finalizohen në fund të vitit 2017. Mirëpo, në 2017 janë publikuar të dhëna vetëm për qarkullimin në prodhimin industrial sipas aktiviteteve ekonomike. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar për herë të parë rezultatet e Statistikave Afatshkurtra të Industrisë, më 29 qershor 2018, i cili përfshin indeksin e vëllimit industrial për tremujorin e parë (TM1) 2018 (2017=100). Ndërsa, më 12 mars 2018, u publikua indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit për vitin 2017.	<u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Nga fillimi i prillit deri më 5 dhjetor 2017, ASK ka publikuar katër Anketa të Fuqisë Punëtore (AFP) në baza vjetore dhe tremujore sipas afatit të paraparë në Kalendarin e Publikimeve të ASK-së, thuhet në raportin e MIE. AFP-ja për tremujorin e katërt 2017 është publikuar më 19 mars 2018 dhe të dhënat vjetore u publikuan më 30 mars 2018. Sa i përket të dhënave të AFP-së për tremujorin e parë 2018 janë publikuar më 18 qershor 2018, ku shohim se iu janë dashur vetëm 18 ditë deri në publikim që tregon përmirësim në shpejtësinë e shpërndarjes së të dhënave.
PËRGJEGJËSI	AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS	AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS	

VEPRIMI	J.4) Anketa mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës	J.5) Publikimi i statistikave të energjisë, të reduktuara dhe statistikave vjetore të efikasitetit të energjisë, të prodhuara në përputhje me standardet ndërkombëtare
GJENDJA	OBJEKTIVË E ARRITUR	OBJEKTIVË NË PROGRES
PËRFUNDIMI	K3 2018	K3 2018
PUNA E BËRË	<u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Gjatë periudhës 1 prill - 30 nëntor 2017, janë realizuar aktivitetet përgatitore dhe planifikimi i kohës dhe resurseve për zhvillimin e anketës në terren. Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare (ABEF) për vitin 2017 është publikuar në uebfaqen e ASK-së më 12 qershor 2018.	<u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Statistikat e efikasitetit të energjisë për 2011-2016 (për sektorin e industrisë dhe ekonomive familjare) u publikuan për herë të parë më 9 mars 2018, ndërsa për sektorin e shërbimeve dhe të transportit do të publikohen në një periudhë të mëvonshme. Sipas vendimit të fundit të kryeministrit, këto duhet kryer deri në fund të shtatorit të këtij viti.

IV. AGJENDA E INTERKONEKTIVITETIT

K. ZBATIMI I TË GJITHA "MASAVE TË BUTA" NË KUADËR TË AGJENDËS SË INTER-KONEKTIVITETIT

PËRGJEGJËSI	MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK - ZRRE, KOSTT.	MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK - ZRRE, KOSTT.	MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK - ZRRE, KOSTT.
VEPRIMI	K.1) Miratimi i Legjislacioni dytësor që rrjedh nga ai primar	K.2) Krijimi i Tregut të përbashkët energjetik me Shqipërinë	K.3) Krijimi i Tregut të aksioneve energjetike me Shqipërinë - KOSTT (një ditë përpara dhe brenda ditës)
GJENDJA	OBJEKTIVË E ARRITUR	OBJEKTIVË NË PROGRES	OBJEKTIVË NË PROGRES
PËRFUNDIMI	K3 2018	K3 2018	K3 2018
PUNA E BËRË	<u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Me 29 mars 2018, Qeveria ka miratuar Rregulloren për 'One-Stop-Shop' përenegjijë e ripërtëritshme. Rregulla për vendosjen e çmimeve të furnizuesit	<u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Kjo çështje mbetet peng i moszbatimit të marrëveshjes së arritur me palën serbe në Bruksel nga ana e Serbisë.	<u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Furnizuesit e rinj për energji elektrike në Republikën e Kosovës janë: <ul style="list-style-type: none"> "KESC" j.s.c "HEP-KS" sh.p.k

	publik të energjisë elektrike nuk ekziston më, dhe është zëvendësuar nga "Metodologjia për përcaktimin e çmimit të ofrimit të shërbimeve universale", e cila është miratuar në prill 2017.	
PËRGJEGJËSI	MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK - ZRRE, KOSTT.	MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK - ZRRE, KOSTT.
VEPRIMI	K.4) Zbatimi i Marrëveshjes ndërmjet KOSTT-EMS	K.5) Harmonizimi i Kodit të rrjetit të KOSTT me atë të ENTSO-E.
GJENDJA	OBJEKTIVË NË PROGRES	OBJEKTIVË NË PROGRES
PËRFUNDIMI	K3 2018	K3 2018
PUNA E BËRË	<u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Komitetit të Energjisë së fundmi i është kërkuar nga Qeveria Gjermane fasiliteti i negociatave mes KOSTT dhe EMS për shkak të vonësive të mëdha në operacionalizimin e linjës së interkoneksionit.	<u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> KOSTT ka transpozuar dispozitat nga DemandConnectionCode (Rule 2016/1388) (shq. Kodi i Lidhjes së Kërkesës) dhe RequirementsforGridConnectionofGenerators (Rule 2016/631) (shq. Kërkesat për lidhjen në rrjet të gjeneratorëve) në Kodin e Rrjetit të KOSTT. KOSTT këtë proces e ka përfunduar. Draft versioni me transpozimet përkatëse i këtij Kodi është dërguar për shqyrtim/aprovim në Komisionin Qeverisës të Kodeve Operacionale (KQKO) dhe në fund dërgohet për aprovim në ZREE.

- "GSA ENERGY" sh.p.k
- "SHARRCEM" sh.p.k
- "JAHA Company" sh.p.k
- Future Energy Trading and Exchange Dynamics" sh.p.k

IV. ENERGJIA

L. RITJIA E SIGURISË SË ENERGJISË DHE MIRATIMI I STRATEGJISË GJITHËPËRFSHIRËSE TË ENERGJISË PËR PERIUDHËS 2017-2026

PËRGJEGJËSI	MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK	MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK	MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK
VEPRIMI	L.1) Miratimi i strategjisë së energjisë 2017-2026 nga Kuvendi	L.2) Miratimi i programit të zbatimit të strategjisë së energjisë 2018-2020	L.3) Investimet e reja në gjenerimin e energjisë
GJENDJA	OBJEKTIVË E ARRITUR	OBJEKTIVË PJESËRISHT E ARRITUR	OBJEKTIVË PJESËRISHT E ARRITUR
PËRFUNDIMI	K1 2018	K1 2018	K1 2018

PUNA E BËRË	<p><u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Kuvendi i Kosovës ka miratuar Strategjinë e Energjisë të Republikës së Kosovës 2017-2026 më 26 janar 2018. Strategjia u miratua me 41 vota për, 18 kundër dhe 9 abstenime.</p>	<p><u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Programi për zbatimin e strategjisë së energjisë ka filluar në shkurt 2018 (menjëherë pas miratimit të strategjisë së energjisë 2017-2026) dhe si i tillë ka përfunduar tashmë dokumenti, ka kaluar të gjitha fazat e konsultimit publike (nga 14 maj deri më 1 qershor 2018) dhe janë marrë deklaratat/opinionet nga MIE, MF dhe zyra për planifikim strategjik. Dokumenti është duke u përgatitur tashmë për dërgim në qeveri për miratim. Meqenëse nuk është miratuar në 2017 siç ishte paraparë, programi për zbatim tani përfshin periudhën 2018-2020.</p>	<p><u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> MZHE raporton investimet në kuadër të burimeve të ripërtrishme të energjisë: Hidrocentrale me autorizime finale që kanë hyrë në operim, me kapacitet të instaluar janë: 31.25 MW. Në proces janë edhe kapacitetet e bazuara në autorizimet finale që janë lëshuar nga ZRRE për kapacitet prej 61.9 MW-Hidroenergji. Energjia diellore fotovoltaike- në operim janë kapacitetet prej 0.6 Kw. Energjia e erës- Në operim është kapaciteti prej 1.35, kurse autorizimi përfundimtar është lëshuar për kapacitetin prej 32.4 MW.</p>
PËRGJEGJËSI	MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK	MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK	
VEPRIMI	L.4) Hartimi dhe miratimi i planit të veprimit për burimet e ripërtrishme të energjisë	L.5) Krijimi i fondit për Eficiencë të Energjisë	
GJENDJA	OBJEKTIVË PJESËRISHT E ARRITUR	OBJEKTIVË E PA ARRITUR	
PËRFUNDIMI	K1 2018	K1 2018	
PUNA E BËRË	<p><u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Sipas MZHE-së, plani i veprimit për burimet e ripërtrishme të energjisë (i rishikuar) është draftuar, është përkthyer në të tri gjuhët, është formatizuar dhe tashmë gjendet në fazën e konsultimit publik. Konsultimi publik do të zgjat nga 12 korriku deri më 1 gusht 2018, që do të thotë do të përfundojë në tremujorin e tretë. Posa të përfundojë kjo fazë e konsultimit do të procedohet tutje për marrje të opinionëve dhe miratim në qeveri.</p>	<p><u>ZHVILLIMET GJATË K1 DHE K2 2018</u> Fondi për Eficiencë të Energjisë është pjesë e projekt ligjit për Eficiencë të Energjisë i cili tashmë është në procedura parlamentare për miratim. Meqenëse ligji nuk është miratuar atëherë as fondi relevant nuk është krijuar.</p>	

4. Përfundim

Politikat e konkurrencës mbeten kritike për funksionimin e mirëfilltë të ekonomisë së tregut edhe mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe të drejtë. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës mban një rol vital për zhvillimin ekonomik duke e siguruar krijimin e tregjeve të konkurrese, si dhe mbrojtjen e konsumatorëve. Siç është paraqitur në këtë studim, AKK-ja, pas një periudhe të gjatë të pasivitetit, i ka rifilluar funksionet e veta në qershor të vitit 2016 pas miratimit të suksesshëm të anëtarëve të Komisionit. Edhe pse që nga ajo kohë Autoriteti ka qenë Aktiv dhe i ka realizuar përgjegjësitë e veta, ende e ka një rrugë të gjatë pranë vetes për të siguruar një ekonomi mirë-funksionale dhe konkurrencën e drejtë në treg. Sa i përket kësaj, specializimi i gjyqtarëve të cilët trajtojnë këto raste, korniza legjislative e harmonizuar mirë e cila nuk shkakton shtim të ligjeve dhe rregulloreve konfliktuoze dhe një shkallë më e lartë të marrjes parasysh të mendimit të Autoritetit nga ana e institucioneve relevante vetëm do ta lehtësonte dhe do të hapte rrugë për një performancë efektive dhe të orientuar nga rezultatet të Autoritetit.

Politika e konkurrencës përfaqëson një kapitull kritik të MSA-së, zbatimi i së cilës është ndihmuar nga PKZMSA dhe ARE. Në lidhje me këtë, ky studim ka monitoruar të gjitha masat që bien nën fushën e konkurrencës e që dalin nga këto dy korniza të punës, të cilat janë paraparë të zbatohen nga institucionet relevante. Lidhur me PKZMSA, të gjitha aktet legjislative që duhet të harmonizohen me “EU acquis” parashihet që të plotësohen deri në fund të vitit 2018. Duhet të ceket se janë iniciuar të gjitha procedurat e nevojshme nga ana e institucioneve relevante.

Në anën tjetër, lidhur me masat që dalin nga ARE, rezultatet nga faza e monitorimit, janar – qershor 2018, tregojnë një mungesë të dedikimit dhe përkushtimit nga ana e institucioneve në drejtim të plotësisht të të gjitha masave të parapara. Gjatë kësaj faze të monitorimit, vetëm 17 nga 44 masat (38.64 përqind) që biejnë nën shtyllën e Konkurrueshmërisë dhe Klimës së Investimeve janë plotësuar krejtësisht. Kjo lë të nënkuptoj një shkallë të pakënaqshme të zbatimit në kuadër të kësaj shtylle.

Si përfundim, institucionet kyçe duhet të tregojnë dedikim dhe përkushtim më të madh në drejtim të plotësisht të të gjitha masave të parapara në ARE dhe PKZMSA në përputhje me afatet specifike dhe me këtë të përshpejtojnë politikat e konkurrencës dhe reformat në Kosovë. Pasi që zbatimi i MSA mbetet proces më kritik për integrimin Evropian të Kosovës, përfshirja, bashkëpunimi dhe përkrahja nga institucionet relevante, përfshirë aty edhe shoqërinë civile, partitë politike dhe mes tjerash komunitetin e biznesit, është e rëndësishë së madhe.

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

“Ky projekt është financuar nga Agjensioni Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida), menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)”

RAPORTET E POLITIKAVE

Raportet e Politikave janë dokumente të gjata të cilat shërbejnë si mjete/forume për të ofruar analiza të detajuara dhe sistematike në sfera të ndryshme të politikave Publike, që janë të dizajnuara të ofrojnë zgjidhje Politikash shkencërisht të mire-informuara për probleme të rëndësishme të politikave Publike. Në përgjithësi, Raportet e Politikave mëtojnë që të ofrojnë argumente të bazuara në vlera, të propozojnë zgjidhje të veçanta në sferën e politikave Publike – për të influencuar kështu argumentet mbi zgjidhjet në fushat e caktuara – duke vënë në përdorim faktet dhe praktikën si mjete për të avancuar argumentet/analizat gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme të organizatës sonë. Në veçanti, ato identifikojnë çështjet themelore të politikave nëpërmjet animeve metodologjike dhe të qëndrueshme, të cilat mundësojnë venien në pah të implikimeve mbi përbërjen/strukturën e politikave të caktuara. Raportet e Politikave, për më tepër, janë kompozime analitike; mbi këtë bazë, ato jo vetëm që ofrojnë fakte apo përshkruajnë ngjarje të caktuara por edhe vlerësojnë politikën Publike për të zhvilluar pyetje dhe analiza, të sigurojnë argumente në përgjigje të ndërlidhjes së politikave, dhe të ofrojnë alternativa/zgjidhje Politikash në një perspektivë gjithëpërfshirëse. Raportet e Politikave shërbejnë si mjet për të ndikuar në procesin e vendim-marrjes dhe për të ftuar në veprim grupet dhe palët e interes në rastet e dhëna.